



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine  
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

01 Ref. 06  
28.04.2021

Mbështetur në nenet 92.4 dhe 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, nenet 53 dhe 55 të Ligjit nr. 05/L-031 të procedurës së përgjithshme administrative, si dhe nenin 8.1.4 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. **Anulohet** Ftesa Publike për emërimin e një (1) trupe për vlerësimin e konformitetit për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore, përkatësisht verifikimin e mjeteve matëse ligjore dhe sistemeve matëse ligjore për matjen e sasisë së lëngjeve të ndryshme nga uji, e shpallur nga Agjencia e Metrologjisë e Kosovës më 27 prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## Arsyetimi

Më 27 prill 2021, Agjencia e Metrologjisë e Kosovës ka botuar në sajtin e Ministrisë “Ftesë Publike për emërimin e një (1) trupe për vlerësimin e konformitetit për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore [...] për verifikimin e mjeteve matëse ligjore dhe sistemeve matëse ligjore për matjen e sasisë së lëngjeve të ndryshme nga uji”.

Ftesa përmban të meta thelbësore.

Së pari, ftesa nuk është botuar sipas nenit 19.1 të Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 12/2018 për mënyrën e autorizimit të trupave për vlerësimin e konformitetit, që parasheh se ftesa “publikohet nga Ministria kompetente”. Në rastin konkret, publikimi është bërë me kërkesën e Agjencisë si “njësia përkatëse brenda Ministrisë kompetente”; sipas nenit 19.4 të Udhëzimit, njësia përgatit ftesën, por nuk e boton vetë.

Së dyti, ftesa parasheh emërimin e vetëm një trupe. Ky kufizim nuk është në përputhje me nenin 35 të Ligjit 06/L-037 për metrologjinë, që parasheh emërimin e trupave në shumës. Gjithashtu ngre shqetësime për cenimin e konkurrencës së lirë. Ndonëse neni 19.1 i Udhëzimit nuk përjashton mundësinë që të emërohet vetëm një trupë, Udhëzimi nuk kufizon paraprakisht numrin e trupave në një. Ngjashëm neni 19.3.2 i Udhëzimit parasheh që ftesa të përcaktojë numrin e nevojshëm të trupave, por ky numër duhet të jetë shumës për të parandaluar krijimin e një monopoli.

Së treti, afati i aplikimit është tejet i shkurtër. Neni 19.5 i Udhëzimit parasheh afatin 15-ditor si afat minimal. Por Ministria ka të drejtë të caktojë afat më të gjatë sipas nevojës. Në rastin konkret, 15 ditë nuk mjaftojnë për t'u siguruar se palët e interesuara janë njoftuar dhe kanë arritur të aplikojnë me kohë. Për më tepër, ftesa nuk është botuar në një pjesë të dukshme të sajtit të Ministrisë. Rrjedhimisht, ftesa bie ndesh me parimin e transparencës, barazisë, paanësisë dhe pritshmërisë së arsyeshme, sipas neneve 6–9 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Duke vërejtur se të metat e sipërcekura e bëjnë ftesën të paligjshme dhe me qëllim për të vendosur ligjshmërinë, u vendos si në dispozitiv.



**Rozeta HAJDARI**

Ministre

***U dërgohet:***

- AMK-së
- Kabinetit të Ministres
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Departamentit Ligjor
- Arkivit